



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 25.02.2013

Nr. 463-125

Për: Agron Berisha, rr. Bedri Shala, nr. 3 Pejë

Lënda: Përgjigje në Ankesë

I nderuari Berisha,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar një ankesë nga Agron Berisha, me kërkesë për anulimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Pejës Nr. 463-7446/2011, që ka të bëjë me të drejtën e Komunës së Pejës për bartjen e të drejtës së pronës të ngastrës kadastrale nr. 687/4, në të cilën si shfrytëzues i lokalit afarist është ankuesi. Lidhur me këtë ankuesi ka parashtruar padi në Gjykatën Komunale në Pejë. Gjykata Komunale Pejë, lidhur me këtë rast ka nxjerrë Aktvendimin me Nr. C. nr 562/11, me të cilin caktohet masa e përkohshme e sigurisë, deri sa të merret një vendim i formës së prerë.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, bazuar në mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores 02/2011 Për Fushat e Përgjegjësit Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, vlerëson se:

- Duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me kontestin i cili është proceduar në gjykatë, atëherë lidhur me këtë kontest të ngritur duhet të pritët vendimi i gjykatës kompetente, si dhe të respektohet masa e sigurisë ashtu siç është përcaktuar me Aktvendimin e lartshënuar.

MAPL, është e përkushtuar të ofrojë përkrahje dhe ndihmë të nevojshme për zbatimin e plotë të këtyre obligimeve që dalin nga legjislacioni i zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

Me respekt,

Slobodan Petrović

Zëvendëskryeministër & Ministër i MAPL

Kopje: Ali Berisha, Kryetar i Komunës së Pejës
Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve në MAPL
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 25.02.2013
br. 463-125

Za: Agron Berisha, ul. Bedri Shala, br. 3 Peć

Predmet: Odgovor na žalbu

Poštovani Berisha,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, je primilo žalbu od strane Agrona Berishe, sa zahtevom za poništenje odluke Skupštine opštine Peć br. 463-7446/2011, tiče se na prava opštine Peć oko prenosa svojine katstarske parcele br. 687/4, u kojoj kupac prostorije je, podnosilac žalbe. U tom smislu podnosilac je, podneo žalbu Opštinskom sudu u Peći. Opštinski sud u Peći, u ovom slučaju je doneo odluku br. C. br 562/11, kojom se određuje privremena mera bezbednosti, dok nebude konačne odluke.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, na osnovu njenog mandata definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-040, dodatak XII uredbi 02/2011n o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije premijera i Ministarstva, procenjuje da:

- S obzirom da se radi o sporu koji je obrađen u sudu, tako da u vezi sa ovim sporom treba se čekati odluka nadležnog suda, kao i da se poštuje mera bezbednosti kao što je određeno gore navedenom odlukom.

MALS je posvećeno da pruža potrebnu podršku i pomoć u cilju potpunog sprovođenja ovih dužnosti koje proističu od strane sprovodljivog zakonodavstva u Republici Kosovo.

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović
Zamenik premijera i Minstar MALS-a

Kopije: Ali Berisha, Gradonačelnik opštine Peć
Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a

I drejtohet: Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)
Adresa: Ndërtesa e ish Pallatit të "Rilindjes"

Për: Departamentin Ligjor të MAPL

Lënda: KËRKESË PËR ANULIMIN
e Vendimit të Kuvendit të Komunës së Pejës Nr. 463-7446/2011, të datës
28.12.2011.



Hyrje

Me 28.12.2011, Kuvendi i Komunës së Pejës ka marrë Vendimin Nr. 463-7446/2011, në të cilit thuhet *cituar:* "Miratohet Propozimi i Drejtorisë për Çështje Pronësore Juridike KK Pejë, për anulimin – shfuqizimin e Kontratës Nr.03-466/134 të dt.20.09.1991, mbi bartjen e të drejtës së pronës komunale në shfrytëzim ngast.kad.687/4, në sipërfaqe prej 0.00,78 ha, në të cilën gjendet dhe lokali afarist, Këshillit Komunal të KL dhe KK të SPS-it Pejë, meqë ky subjekt nuk ekziston më dhe ta bëjë bartjen e të drejtës së pronësisë në fjalë në trashëgimtarin ligjor Komunën e Pejës".

Vendimi i cituar si më sipër është sa i kundërligjshëm aq dhe paradoksal, meqë i njëjti bije në kundërshtim të plotë me cilin do ligj në fuqi në Kosovë dhe përbën një kaos të vërtetë i cili është vështirë të shpjegohet në aspektin profesional. Në të njëjtën kohë, Ky Vendim përbën tejkalim të hapur të fushëveprimit dhe kompetencave të organeve të administratës në nivelin lokal të parapara së paku me Ligjin 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (neni 14), me Ligjin Nr. 03/L-189 Për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, me Ligjin për Procedurën administrative, e posaçërisht bije ndesh në çdo aspekt me Ligjin 03/L-154 Për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore dhe cilin do ligj në fuqi i cili i referohet dhe/ose rregullon të drejtat pronësore.

a) Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 16.01.1999, nga cilësia ime si palë, i jam drejtuar Komisionit për evidentimin dhe mbrojtjen e pronës shoqërore dhe publike të Komunës së Pejës, me një kërkesë për marrjen në shfrytëzim të lokalit afarist i cili gjendet në ngastrën kadastrale nr. 687/4. Vendimi i Komisionit Nr. 07-353-1930 i datës 27.12.1999 ishte lëshuar në atë kohë nga jo pronari, në mungesë të evidencës kadastrale deri në identifikimin e pronarit të vërtetë.

Provë: Kërkesa

Vendimi Nr. 07-353-1930 i datës 27.12.1999.

Që nga viti 1999 nga hyrja në posedim kam hulumtuar për dokumentacionin pronësor pandërprerë deri sa në vitin 2003, nga nëpunës të kësaj Komune kam siguruar Çertifikatën e Drejtorisë për gjeodezi, kadastër dhe pronësi Nr.01-3/2242, të datës

30.09.2003 në të cilën shprehimisht thuhet *cituar*: “Sipas regjistrit të ndërrimeve 139/1991... ngastrë kadastrale nr. 687/4 (shtëpi) me sipërfaqe prej 0.00,78 ha regjistrohët në emër të Komitetit Komunal të LK Pejë sipas fletës së posedimit nr. 715 KK Pejë, në emër të së cilës udhëhiqet edhe tani...” *Më tej thuhet*: “Ndërrimi u bë në bazë të Kontratës mbi bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të përhershëm të KK Pejë Nr. 03-466/134 të datës 20.09.1991”.

Provë: Çertifikata e Drejtorisë për gjeodezi, kadastrë dhe pronësi Nr.01-3/2242, datë 30.09.2003.

Duke filluar nga viti 2008/9, individ të caktuar të Komunës së Pejës, me të kuptuar se pronësia mbi ngastrën kadastrale dhe lokalin lëndor nuk i takon Komunës por një subjekti plotësisht tjetër, kanë shfrytëzuar pozitën dhe autorizimet e tyre si nëpunës dhe kanë ushtruar në mënyrë të vazhdueshme akte ndikimi, presioni, pengim posedimi, e deri tek cenimi i integritetit moral dhe familjar me qëllim që poseduesi ta liroj lokalin lëndor. Përpos kësaj, nëpunës të Komunës kanë falsifikuar fatura të tatimit në pronë, kanë inskenuar situata të ndryshme dhe kanë kërkuar nga poseduesi që domosdo të hyjë në raporte të qirasë. Lidhur me këtë, nëpunës të Komunës kanë përgatitur një kontratë për qira nga e cila shihet se Komuna as që figuron si palë por Drejtoria për çështje pronësore e cila nuk e ka cilësinë e subjektit e as legjitimitetin e palës për çfarëdo kontrate qoftë ajo.

Provë: Ftesa të ndryshme dhe nga organe të ndryshme.

Faturat e falsifikuara të tatimit në pronë.

Kontrata e qirasë, e Drejtoratit për çështje juridiko pronësore.

Për hir të sigurisë, nga cilësia ime si posedues kam kontaktuar administratën e Gjykatës Komonale në Pejë dhe jam informuar se: Meqë Komuna nuk është pronare dhe nuk ka legjitimitetin si palë, kontrata e tillë e qirasë nuk mund të legalizohet në gjykatë. Në shenjë revolte nëpunës të Komunës kanë bërë shpallje publike për dhënien me qira të lokalit lëndor dhe prapë kanë ushtruar ndikim tek anëtarët e familjes sime që të marr pjesë në ankand.

Provë: Njoftim për ankand (ngastrën kadastrale 687/4).

Lidhur me ankandin e cituar si më sipër, i jam drejtuar Drejtorisë për çështje pronësore me një Kërkesë përmes së cilës kam kërkuar përgjigje me shkrim lidhur me faktin se: Cila është baza juridike e shpalljes së këtij ankandi dhe a ka Komuna juridiksion mbi ngastrën dhe lokalin lëndor.

Provë: Shkresa e paditësit, datë 06.6.2011, Nr.15-463-4191.

Në shenjë revolte ndaj kërkesës së cituar si më sipër, Drejtoria për çështje pronësore ka nxjerrë Aktvendim 15-463/59/2011, datë 14.09.2011 dhe Konkluzionin me të njëjtin numër të datës 08.11.2011, sipas të cilit i është urdhëruar poseduesit lirimi i lokalit lëndor. Aktvendimi i cituar është lëshuar edhe përkundër faktit se, Drejtoria për Gjeodezi dhe kadastrë e po kësaj Komune i ka dërguar Drejtorisë për çështje pronësore Historikun e ngastrës kadastrale ku vërtetohet në mënyrë të pakontestueshme fakti se: Komuna nuk është pronare e lokalit lëndor dhe ngastrës kadastrale në rastin konkret.

Provë: Aktvendimi 15-463/59/2011, dt. 14.09.2011 dhe Konkluzioni i dt. 08.11.2011.

Historiku, i Drejtorisë për Gjeodezi dhe kadastrë. Datë: 09.06.2011

Kundër Aktvendimit të cituar si më sipër kam ushtruar ankesë, e cila përmes organit të shkallës së parë i është adresuar organit të shkallës së dytë. Sapo organi i shkallës së parë është njoftuar lidhur me ankesën dhe qëllimin e saj, e ka refuzuar për pranim menjëherë.

Provë: Shih faqen e parë të ankesës ku është fshirë vula e pranimit.

Për shkaqet e cituara si më sipër, e kam dërguar personalisht ankesën në organin e shkallës së dytë, i cili kishte marrë Aktvendim me të cilin ankesën e ka refuzuar si e pabazuar. Në të vërtetë që nga data 17.10.2011, respektivisht nga koha e marrjes, Aktvendimi i organit në shkallë të dytë nuk më është dorëzuar asnjëherë, me qëllim dhe/ose prapavijë që të privohem nga mundësia e ushtrimit eventual të Padisë për iniciimin e konfliktit administrativ.

Provë: Aktvendimi (data në faqen e dytë) dhe fletë pranimi (shih datën).

Duke e ditur se poseduesi nuk është në dijeni për Aktvendimin e organit në shkallë të dytë, nëpunës të pandërgjegjshëm të Komunës e kanë urdhëruar prapë poseduesin për lirim të lokalit lëndor. Për këtë arsye, kam ushtruar Padi në Gjykatën Komunale të Pejës (precizuar në ndërkohë nga aspekti i legjitimacionit pasiv) dhe kam propozuar aplikimin e masës së përkohshme të sigurisë. Gjykata Komunale në Pejë me 11.11.2011 ka marrë Aktvendimin C.nr. 526/11 sipas të cilit: Caktohet masa e përkohshme e sigurisë kundër të paditurës Komuna e Pejës.

Provë: Aktvendimi i Gjykatës Komunale të Pejës C.nr.526/11, i datës 11.11.2011.

Në shenjë revolte kundër Vendimit të Gjykatës Komunale të Pejës, nëpunës (individ) të Komunës kanë iniciuar në Kuvend miratimin e Propozimit të Drejtorisë për Çështje Pronësore të cilën Kuvendi i Komunës e ka miratuar pa e ditur në fakt se si qëndron gjendja reale, cila është baza juridike e ndryshimeve pronësore, a bije kjo pronë nën juridiksionin e Komunës, a ka të drejtë Komuna të shpallë ankand për një pronë të huaj dhe a ka të drejtë të urdhëroj ndryshime pronësore në mënyrë të tillë.

Provë: Shih faqen 3, të procesverbalit.

c) Baza ligjore e kërkesës

E drejta e shfrytëzimit të përhershëm mbi ngastrën kadastrale 687/4 dhe lokalit lëndor që në vitin 1991, ka kaluar në pronësi të një subjekti plotësisht tjetër dhe atë të Komitetit Komunal në Pejë. Komiteti Komunal për nga cilësitë e tij, fushëveprimi, pronësia dhe subjektiviteti, nuk ka kurrfarë lidhje me Kuvendin Komunal.

Provë: E pakontestueshme.

Edhe sipas Ligjit (të mëparshëm) mbi marrëdhëniet themelore juridiko pronësore (LMThJP) dhe Ligjit në fuqi 03/L-154 Për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, parashihet shprehimisht se: “Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri”.

Provë: Çertifikata e cituar si më sipër Nr.01-3/2242, datë 30.09.2003. *Shih citatin:* “Ndërrimi u bë në bazë të Kontratës mbi bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të përhershëm të KK Pejës Nr. 03-466/134 të datës 20.09.1991”.
Nenet 1 dhe 20, i LMThJP (Gaz/Zyrt.RSFJ Nr.827/1980)
Nenin 36.1. i Ligjit 03/L-154 Për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore

Nga ana tjetër, në nenin 14.3. të Ligjit 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale thuhet: “Komunat mbajnë dhe udhëheqin regjistrin e pronës së luajtshme dhe të paluajtshme që e kanë në shfrytëzim dhe posedim”. Dispozita ligjore në rastin konkret nënkupton faktin publik se, Komuna administron me pasurinë e cila evidentohet në emër të saj, e jo me pasurinë e huaj.

Provë: Ligji 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (neni 14).

Është po ashtu publikisht i njohur fakti se, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin 03/L-34 Për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, e cila ka kompetenca ekskluzive mbi të gjitha Ndërmarrjet Shoqërore dhe pronat e tyre. Nëse ngastra kadastrale 687/4, do të ishte pronë shoqërore, shtrohet pyetja: çfarë të drejte ka Komuna e Pejës që ta trajtoj në çfarëdo procedimi administrativ statusin e ndonjë prone të ndonjë ndërmarrje shoqërore e cila sipas fuqisë ligjore nuk bije absolutisht nën administrimin e komunës por të AKP-së.

Provë: Ligji 03/L-34 Për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Parashtruesi i kësaj kërkesë është posedues i ligjshëm dhe me mirëbesim i ngastrës kadastrale Nr. 687/4 dhe lokalit lëndor që nga viti 1999, pikërisht ashtu siç kërkohet me nenin 103 të Ligjit 03/L-154, sipas të cilit “Personi i cili e ushtron pushtet faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë”. Të drejtat e posedimit janë konstituuar në harmoni të plotë me nenin Neni 104 të Ligjit 03/L-154, sipas të cilit “Posedimi në një send fitohet me krijimin e pushteti faktik mbi sendin. Marrëveshja e poseduesit të mëparshëm dhe e fituesit të posedimit është e mjaftueshme për fitimin e posedimit, nëse fituesi është në gjendje që të ushtrojë pushtetin mbi sendin në momentin e marrëveshjes”.

Provë: Posedimi si fakt, i pakontestueshëm.

Marrëveshja me pronarin, fakt i pakontestueshëm.

Ligji 03/L-154, Nenet 103, 104.

I kujtohet në këtë rast MAPL, se Poseduesi është në fqinjësi me një ngastër kadastrale në pronësi të një ndërmarrje shoqërore e cila pikërisht në të njëjtën mënyrë dhe si në këtë rast, ishte përfshirë në një procedim të tillë administrativ duke ju nënshtruar ndryshimeve pronësore pa asnjë bazë juridike. Poseduesi ka kuptuar po ashtu se Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Vendimin e Komunës së Pejës në rastin konkret e ka shpallur të kundërligjshëm.

Provë: Vendimi i MAPL, Nr. III 02-245/1, i datës 07 Prill 2011

Përfundimisht, Vendimi i atakuar i Komunës së Pejës Nr. 463-7446/2011, përbën një kaos veprimesh dhe përmban formulime paradoksale, të cilat si të tilla nuk kanë lidhje me njohuritë dhe institutet ligjore të konceptit pronësor, së paku për sa vijon:

- Formulimi “Miratohet Propozimi i Drejtorisë për Çështje Pronësoro Juridike KK Pejë, për anulimin – shfuqizimin e Kontratës Nr.03-466/134 të dt. 20.09.1991...” nuk konsiston në ndonjë të drejtë të tillë sipas legjislacionit në fuqi, sepse asnjë subjekt kushdo qoftë, nuk ka të drejtë që *kur ti teket*, në çdo kohë, sipas dëshirës individuale të cilit to nëpunës, organ apo funksionar, ta ndërroj karakterin e pronësisë mbi një send i kujt do qoftë, në mënyrë të njëanshme dhe arbitrarisht.

- Formulimi si në vijim “...mbi bartjen e të drejtës së pronës komunale në shfrytëzim ngast. kad. 687/4, në sipërfaqe prej 0.00,78 ha, në të cilën gjendet dhe lokali afarist...” është mashtrues, sepse Kontratën dhe Vendimin e Komunës të datës 1991 thuhet decidivisht: “Ndërrimi u be në bazë të Kontratës mbi bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të përhershëm të KK Pejë Nr. 03-466/134 të datës 20.09.1991”. Ky akt nënkupton definitivisht bazën e bazën e pakontestueshme dhe/ose punën juridike për bartjen e të drejtave dhe të pushtetit të plotë pronësor mbi titullarin e rij.

- Formulimi në vijim se “...meqë ky subjekt nuk ekziston më...” është prapë një absurd, sepse Komuna as që e ka vërtetuar faktin e ekzistencës apo jo të titullarit dhe aq më tepër shuarja e një subjekti nuk është punë e një organi të tillë dhe as e një Vendimi të tillë.

- Formulimi në vijim “...ta bëjë bartjen e të drejtës së pronësisë në fjalë në trashëgimtarin ligjor Komunën e Pejës” është po ashtu absurd sepse titullari ekziston kurse Komuna e Pejës nuk mund ta shpallë veten trashëgimtar të subjektit ekzistues e aq më tepër të Komitetit Komunal.

Si rrjedhojë e shkeljeve të përshkruara si më sipër, Vendimi i atakuar i Komunës së Pejës është në të njëjtën kohë në kundërshtim të plot me nenin 56 të Ligjit 03/L-189 sipas të cilit organet e administratës shtetërore janë të detyruara, që qytetarëve t’iu mundësojnë realizimin e papenguar, ligjor dhe me kohë të të drejtave të tyre dhe detyrimeve; t’iu japin informata të nevojshme dhe shënime; t’iu ofrojnë ndihmën juridike pa diskriminim; të respektojnë dinjitetin dhe personalitetin e secilit qytetar; të ruajnë dhe avancojnë nivelin dhe autoritetin e organeve të administratës shtetërore rrjedhimisht të bashkëpunojnë, në suaza të kornizave ligjore, korrekte dhe civilizuese me qytetarët e Republikës së Kosovës dhe me secilin individ që i drejtohet me gojë apo me shkrim për ndonjë kërkesë, nevojë, të drejtë ose interes juridik, ekonomik ose qytetar.

Parashtruesi i kësaj kërkesë konsideron se faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër së bashku me provat e bashkëngjitura janë të mjaftueshme për të krijuar bindjen e MAPL se Vendimi i Komunës së Pejës Nr. 463-7446/2011, i datës 28.12.2011, përbën një akt tipik arbitrar dhe të kundërligjshëm me ç’rast i propozon MAPL, që në kuptim të nenit 61 (Qëllimi i mbikëqyrjes) të Ligjit 03/L-189, të marri sikurse vijon:

V E N D I M

Shpallet i kundërligjshëm Vendimi i Komunës së Pejës Nr. 463-7446/2011, i datës 28.12.2011.

Parashtruesi,

Agron Berisha

Posedues i ngastrës dhe lokalit lëndor

Adresa: Bedri Shala, nr.3 Pejë

axberisha@hotmail.com

044 666 071

Bashkangjitur: Provat e cituara

NR. DOK.	NUMER	DATA	VIT
07353	-	1930/99	

KESHILLI KOMUNAL PEJË
Komisionit për mbrojtjen dhe evidentimin e PFSE.

KERKESË PËR MARRJEN E LOKACIONIT ME QIRA

Me anë të kësaj kerkese i drejtohem organit në fjalë që të ma leshoi vendimin-kontratan me të cilën dëshiroi që të krijoi raporte për themelimin e marrëdhënies së qirasë për shfrytëzimin e lokacionit i cili gjindet i pa rregulluar në mes të objekteve të NHT "RUGOVA" dhe lokaleve të Agrometohisë në Pejë, e cila gjindet në anën e djathtë të rrugës shquar në drejtim të Gjakutës.

Ceku se për pronarin e vertetë jam interesue që 4 muaj. Në bisedë me personat përgjegjës të OP "Agrometohija" me është thënë se edhe pse evidentohet formalisht në emër tonë në kataster, ajo është pronë e NHT "RUGOVA" në Pejë. Personat përgjegjës nga NHT "RUGOVA" me është thënë se marrëdhënjet juridiko-pronsore lidhur me at vend ende nuk janë të definuar, por nga ne nuk do të keshë pengesa. Duke u bazuar në këtë unë kam hye në POSIDIM të të njëjtit lokal-lokacion, e kam pastruar dhe kam ndermarrë veprime të caktuara për rregullimin e tij.


Përkitazi me këtë janë të njohuar edhe disa persona zyrtarë të keshillit komunal të cilët ma kanë dhënë pëlqimin gojorisht.

Me këtë kerkese dëshiroj që të legalizohen veprimet e mia e mos të të pengohem nga persona të tretë.

Pejë, 15.11.1999 vit.

Paraqitësi i kerkesës,

Agon Bërisha, Pejë.



KËSHILLI KOMUNAL PEJË

- Komisioni për evidentimin dhe mbrojtjen e pronës shtetërore dhe private -

Numër: 07-353-1930/99

Pejë, më 27.12.1999.

Komisioni për evidentimin dhe mbrojtjen e pronës shtetërore dhe private të KK Pejë, duke vendosur lidhur me kërkesën e ADRON BERISHES nga Peja për dhënien e lokalit afarist në shfrytëzim të përkohshëm, në pajtim me nenin 10, alinea 1, pikat 1,3, 5 dhe 7. të Rregullores për evidentimin dhe mbrojtjen e pronës shtetërore dhe private në Republikën e Kosovës, marr këtë:

V E N D I M

I. PRONA - lokali afarist i braktisur që gjendet në Pejë, në rr. Adam Jashari ish rr. M.Tito i ipet në shfrytëzim të përkohshëm ADRON BERISHES nga Peja e me qëllim të kryerjes së veprimtarisë afariste, për çka është regjistruar në organin kompetent.

II. Shfrytëzuesi është i obliguar që t'a bëjë regjistrin e inventarit të lokalit në fjalë sipas gjendjes para hyrje në posedim dhe t'ia dorëzojë Organit kompetent komunal.

III. Shfrytëzuesi është i obliguar që ta lidh Kontratën mbi qiranë për shfrytëzimin e lokalit nga pika I të Vendimit me Këshillin komunal Pejë, në kohë të caktuar deri një vit me të drejtë të vazhdimit të saj.

A r s y e t i m

Adron Berisha nga Peja ka kërkuar nga Këshilli komunal Pejë, që t'i ndalet në shfrytëzim të përkohshëm lokali afarist i cili gjendet në Pejë, në rr. A.Jashati duke cekur se lokali në fjalë është i lirë.

Në procedurë është verifikuar:

- Sipas Vendimit të Komisionit E.M.P.SH.P të KK Pejë, nr. 07-353-1930/99 të dt. 27.12.1999 v. prona-lokali afarist nga pika I e këtij Vendimi vihet nën administrimin dhe disponimin e përkohshëm të Këshillit komunal Pejë, për arsye se evidentohet si pronë e braktisur.

- Gjithashtu është verifikuar që parashtuesi i kërkesë ushtron veprimtari të pavarur, për çka është i regjistruar pranë Organit kompetent.

Me qëllim të evidentimit dhe të mbrojtjes së pasurisë në fjalë, nga keqpërdorimet dhe uzurpimet eventuale, Komisioni në harmoni me nenin 10 alinea 1, pikat 1,3,5 dhe 7. të Rregullores mbi evidentimin dhe mbrojtjen e pronës shtetërore dhe private në Republikën e Kosovës, si dhe dispozitave tjera pozitive që e rregullojnë këtë materie, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzim Juridik: Kundër këtij Vendimi lejohet ushtrimi i ankesës në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së tij - Komisionit për evidentimin e mbrojtjes së pronës shtetërore dhe private të Kosovës e nëpërmjet të këtij Komisioni /Komisioni E.M.P.SH.P. KK Pejë/.

Vendimi t'i dorëzohet: Shfrytëzuesit, një kopje në Shërbimin pronësoro-juridik.



KRYETARI I KOMISIONIT,

Adem Kallidaku

KUVENDI KOMUNAL
Drejtoria per kadastrer,
gjeodezi dhe pronesi
Nr. 01-3/ 2242
Data 30.09.2003 vit.
P E J E

Ne baze te nenit 171. te Ligjit mbi proceduren e pergjithshme administrative, duke vendosur sipas kerkese se Xhelal Kasapollu nga Peje, Drejtoria per kadastrer, gjeodezi dhe pronesi ne Peje leshon kete :

Ç E R T I F I K A T E

Ne baze te evidences zyrtare me te cilen disponon kjo Drejtori ngastra kadastrale nr. 687 (shtepi-0.03.59 ha, oborr-0.05.00 ha dhe are-0.14.77 ha) ne sipërfaqe prej 0.23.36 ha me reambulimin e kadastrit nga viti 1955 - 1956 regjistrohet ne emerr te Markoviq Marka Kosta nga Peja sipas fleteposedimit nr. 302 K.k. Peje .

Sipas regjistrimit te ndrimeve nr. 132/63 ngastra e lartcekur ne sipërfaqe te tersishme regjistrohet ne emerr te : Joksimoviq Milosh me 1/4-en, Joksimoviq Miodrag me 1/4-en dhe Joksimoviq Mishko me 1/4-en sipas fleteposedimit nr. 4214 K.k. Peje (ndrimit u be ne baze te Aktvendimit mbi trashigim _ Gjykata komunale ne Peje T.nr. 200/62 te dt. 26.02.1963) .

Ne vitin 1966 sipas regjistrimit te ndrimeve nr. 311/66 ngastra nr. 687 ndahet ne dy pjesë dhe ate : ngastren nr. 687/1 (shtepi-0.05.06 ha dhe oborr-0.05.00 ha) ne sipërfaqe prej 0.10.06 ha e cila mbeti ne emerr te bashkepronareve Joksimoviq Milosh me 1/2-en, Joksimoviq Miodrag me 1/4-en dhe Joksimoviq Mirko me 1/4-en ne emerr te cileve udhëheqet edhe tani sipas fleteposedimit nr. 3889 K.k. Peje ndersa ngastra kadastrale nr. 687/2 (shtepi - 0.06.16, oborr- 0.05.00 ha dhe are- 0.02.14 ha) ne sipërfaqe prej 0.13.30 ha regjistrohet ne emerr te Kooperatives bujqesore Peje sipas fleteposedimit nr. 1819 K.k. Peje (ndrimit u be ne baze te kontrates nr. 1475/66) .

Sipas regjistrimit te ndrimeve nr. 139/1991 behet ndarja e ngastres nr. 687/2 ne baze te kerkese Q1-5/116 te dt. 01.08.1991 vir me c' rast formohen : ngastra nr. 687/2 (objekt- 0.03.37 ha, oborr-0.03.00 ha dhe are -0.02.14 ha) ne sipërfaqe prej 0.10.49 ha, nr. 687/3 (shtepi) ne sipërfaqe prej 0.01.41 ha, nr 687/5 (shtepi) ne sipërfaqe prej 0.00.60 ha te cilat mbeten si prone e kooperatives bujqesore _ Peje sipas fleteposedimit nr. 1686 K.k. Peje, ndersa ngastra kadastrale nr. 687/4 (shtepi) ne sipërfaqe prej 0.00.78 ha regjistrohet ne emerr te Komitetit komunal te L.K. Peje sipas fleteposedimit nr. 715 K.k. Peje ne emerr se cilit udhëheqet edhe tani (ndrimit u be ne baze te kontrates mbi barten e se drejtes te shfrytimit te perbershem te KK Peje nr. 03-466/134 te dt. 20.09.1991 vit) .

Ne vitin 1994 sipas regjistrimit te ndrimeve nr. 11/94 ngastra nr. 687/3 ne sipërfaqe te tersishme regjistrohet ne emerr te Ndermarjes hoteliere turistike Metohija sipas fleteposedimit nr. 8105 K.k. Peje ne emerr se ciles udhëheqet edhe tani (ndrimit u be ne baze te Vendimit KK Peje nr. 01-10037/1960 te dt.28.04.1960 v, nr. 01-8945/1-1968 te dt. 22.06.1968 v. dhe nr. 01-9500/1-1965 te dt.29.05.1965) .

Ngastret nr. 687/2 dhe 687/5 edhe tani udhëheqen ne emerr te Kooperatives bujqesore Peje.

Çertifikata leshohet me kerkesen e pales e i sherben per regullimin e çeshtjes pronesore.

E punon
Sami Krasniqi
Sami Krasniqi



DREJTORI

insh. p. Aud. Maxhun Hyseni
insh. p. Aud. Maxhun Hyseni

DREJTORATI I INSPEKSIONIT
SEKTORI I NDËRTIMIT

Numër: 13/354/

FLETËDORËZIM

Lloji i Vendimit	I dërgohet		Data pranimit dhe nënshkrimi i pranuesit	Nënshkrimi i dorëzuesit
	Emri e Mbiemri	Adresa		
FTOSE PËR PALËN	FATON BERISHA	Rr. "Mbretëresha Teudë"	28/01/2011	FICHEZ PALA TE PARARITET NË ZYRËN NNT, MË DATË 31/01/2011, NË ORA 9:00

F. Berisha



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

Drejtoria për çështje pronësore-juridike

Numër: Zyrtarisht

Datë: 25.03.2011

Ftesë

Ftohet AGROM BERISNA nga PEJA


Rr. M. TEUTA nr 7 që të paraqiten apo të dërgojë përfaqësuesin (të autorizuar) me dt 28.03 2011 në ora 10⁰⁰ në ndërtesën e Kuvendit të Komunës në Drejtorin për çështje pronësoro-juridike. Ju njoftojmë që të paraqiteni në këtë Drejtorat për të lidh marrveshje të perkohshme "Kontratë" për shfrytëzim të dyqanit i cili është pronë e KK Pejë.

Ardhja Juaj është e obligueshme

Vërejtje: Mospërgjigja në ftesë konsiderohet si praninë e gjendjes faktike dhe organin administrativ nuk e pengon që të marr veprime të mëtutjeshme.



Drejtori për çështje pronësoro-juridike


Mr. Afrim Selimaj



FLETËDORËZIMI-DOSTAVNICA - INVOICE

Numri/Number/Broj 2477 / 2011

Titulli i shkresës Naziv pismena Title of document	Kujte i dërgohet shkresa Kome se pismeno dostavljaja Emri e mbietmri ose titulli Ime i prezime-naziv Name and surnants-of title	Krago e numri Ullica i broj Street and number	Data e marrjes dhe nënshkrimi i marrësit Datum prijemo i potpis primaoca Date of receipt and signing of makers	Nënshkrimi i dorëzuesit Potpis dostavljaca Signing of
Kerkesë për SHPALLJEN E TENDËRIT	MEMANËRI KHEN BERISHES	K.K. Pajë	25.03.11 	

Drejtorati për çështje Pronësoro-Juridike
Numër: Zyrtarishit
Datë: 25.03.2011

FLETËDORËZIMI

Z. Alban Berisha nga Përia Rr. M. Teona nr. 7
Ftesën e pranova me dt. 25.03.2011

Nënshkrimi i marrësit
Alban Berisha
No. 14009 / 10
punitorot e byrosit

nënshkrimi i dorëzuesit




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike
Numër:zyrtarisht /2011
Datë; 23.02.2011



Ftesë

Ftohet FATON BERISHA nga Peja

Rr. M. TELITË nr. Lok. DONER që të paraqiten apo të dërgojë përfaqësuesin (të autorizuar) me dt 29.02 2011 në ora 10⁰⁰ në ndërtesën e Kuvendit të Komunës në Drejtorin për çështje pronësoro- juridike, ne Katin e dytë, lidhur me dhënjen e informatave që ka të bëjë me posedimin e lokalit në Rrugen M. Teut LODNER. Me vëdi mund të sjellni të gjitha dëshmitë e pronës që do të na ndihmojnë në zgjidhjen e kësaj çështje.

Ardhja Juaj është e obligueshme

Vërejtje: Mospërgjigja në ftesë konsiderohet si pranimit i gjendjes faktike dhe organin administrativ nuk e pengon që të mer veprime në mungesë.

Drejtori për çështje pronësoro-juridike


Mr. Afrim Selimaj



Drejtorati për çështje Pronësoro-Juridike
Numër:zyrtarisht
Datë: 23.02.2011

FIETËDORËZIMI

I Felon BERINA nga Peja Rr M. Taurë nr -
Ftesën e pranovë me dt 23.02.2011 nr Zgjidhjet

Nënshkrimi i marrësit
AGRI

nënshkrimi i dorëzuesit


Drejtorati për çështje Pronësoro-Juridike
Numër:zyrtarisht
Datë: 10.03.2011

FIETËDORËZIMI

I EDTON BEKRI nga Peja Rr M. Taurë nr 10.03.2011 nr 10.03.2011

Nënshkrimi i marrësit
Edton Bekri

nënshkrimi i dorëzuesit


Punëtorës AV DUKA
Te DUKA



Fatura për Tatimin në Pronë
Raçun o Porez na Imovinu
Property Tax Bill



Pejë
Peç

N.H.T.T. "RUGOVA"
122/2 MBRETËRESHA TEUTË, 49, 49
30000 Pejë/Peç
PEJË/PEÇ

Data e lëshimit të faturës:
Datum izdaje računa: 2010-12-07

INFORMATAT E PRONËS / INFORMACIJE ZA IMOVINU / PROPERTY INFORMATION

Sipërfaqja Površina Area	Kategoria e pronës Vrsta imovine Property Category	Zona e Vlerësimit Porezka Zona Value Zone	Vlera e Llogaritur Raçunata Vrednost Appraised Value	Zbritja për Banim Kryesor Sniženje za Glavno Boravište Principle Residence Deduction	Norma Tatimore Porezka Stopa Tax Rate
67 m ²	Për Afarizëm	I	€ 80,400	€ 0	0.15 %

INFORMATAT FINANCIARE / FINANCIJSKE INFORMACIJE / FINANCIAL

1384/1

Për pronën tuaj për vitin 2010 është vlerësuar tatimi 120.60
Za vašu imovinu za 2010 godine procenjen je 120.60
For your property the assessed tax for 2010 120.60

Shumat dhe datat e pagesës / Iznos da se plati / Amounts and payments dates

Specifikimi Specifikacija Specification	Afati / Pagesës Rok Plaćenje Due Date	Shuma Iznos Amount
Tatimi 2010 Kësti I Parë Porez 2010 Prva Rata Tax 2010 First Installment	30 Qërshor 30 Jun June 30	60.30
Tatimi 2010 Kësti I Dytë Porez 2010 Druga Rata Tax 2010 Second Installment	31 Dhjetor 31 Decembar December 31	60.30
Borxhi nga vitet e kaluara përfshinë kamatën dhe dënimet Dug iz predhodnih godina obuhvata kamate i kazne Debt from previous years including interest and penalties	Paguani menjëherë Platite odmah Pay immediately	1,160.48
Totali / Total / Total		1281.08

Pas skadimit të afatit aplikohet kamata prej 1% dhe dënimet prej 5%. Nëse pagesa vonohet më shumë se 60 ditë, do të llogaritet edhe 10% dënim shtesë.
Borxhi nga vitet e kaluara duhet të paguhet menjëherë për të evituar kumatën shtesë.

Posle zakasnele uplate plaća se kamata od 1% i kazna od 5%. Ukoliko zakasnite više od 60 dana, izračunava se dodatno, zatezna kamata do 10%.

After due date interest of 1% and penalty of 5% is applied. If payment is delayed more than 60 days an additional penalty of 10% is applied.
Debts from previous years must be paid immediately to avoid additional interest.

TË PLOTËSOHET NGA BANKA / POPUNJAVA BANKA / TO BE COMPLETED BY BANK

Shuma e Paguar/Plaćeni Iznos/Amount Paid: _____ Komuna/Opština/Municipali Pejë
Data e Pagesës/Datum Plaćenja/Payment date: _____ Emri i Tatimpaguesit/Ime Poreznika/Taxpayer Name
Emri i Bankës/Ime Banke/Bank Name: _____ N.H.T.T. "RUGOVA"
Nr. i faturës / Br Raçuna / Bill No: _____
Nr. i Llogarisë/Br. žiro Raçuna/Account No: 1000650210000025 117838 / 3171757



Pejë
Peç

Fatura për Tatimin në Pronë
Raçun o Porez na Imovinu
Property Tax Bill



* P E B 2 K O 0 1 4 F 9 E O B 1 3 *

N.H.T.T. "RUGOVA" PEJË

122/2 MBRETËRESHA TEUTË, 49, 49
30000 Pejë/Peç
PEJË/PEÇ

Data e lëshimit të faturës:

Datum izdanje računa:

2010-12-07

INFORMATAT E PRONËS / INFORMACIJE ZA IMOVINU / PROPERTY INFORMATION

Sipërfaqja Površina Area	Kategoria e pronës Vrsta imovine Property Category	Zona e Vlerësimit Porezka Zona Value Zone	Vlera e Llogaritur Raçunata Vrednost Appraised Value	Zbritja për Banim Kryesor Sniženje za Glavno Boravište Principle Residence Deduction	Norma Tatimore Porezka Stopa Tax Rate
67 m ²	Për Afarizëm	I	€ 80.400	€ 0	0.15 %

INFORMATAT FINANCIARE / FINANCIJSKE INFORMACIJE / FINANCIAL

1384/1

Për pronën tuaj për vitin 2010 është vlerësuar tatimi 120.60
Za vašu imovinu za 2010 godine procenjen je 120.60
For your property the assessed tax for 2010 120.60

Shumat dhe datat e pagesës / Iznos da se plati / Amounts and payments dates

Specifikimi Specifikacija Specification	Afati i Pagesës Rok Plaćenje Due Date	Shuma Iznos Amount
Tatimi 2010 Kësti i Parë Porez 2010 Prva Rata Tax 2010 First Installment	30 Qërshor 30 Jun June 30	60.30
Tatimi 2010 Kësti i Dytë Porez 2010 Druga Rata Tax 2010 Second Installment	31 Dhjetor 31 Decembar December 31	60.30
Borxhi nga vitet e kaluara përfshinë kamatën dhe dënimet Dug iz predhodnih godina obuhvata kamata i kazne Debt from previous years including interest and penalties	Paguani menjëherë Platite odmah Pay immediately	1,160.48
Totali / Total / Total		1281.08

Pas skadimit të afatit aplikohet kamata prej 1% dhe dënimet prej 5%. Nëse pagesa vonohet më shumë se 60 ditë, do të llogaritet edhe 10% dënim shtesë.
Borxhi nga vitet e kaluara duhet të paguhet menjëherë për të evituar kamatën shtesë.

Poate zakasneje ulcate plaća se kamata od 1% i kazna od 5%. Ukoliko zakasnite više od 60 dana, izračunava se dodatno, zatezna kamata do 10%.

After due date interest of 1% and penalty of 5% is applied. If payment is delayed more than 60 days an additional penalty of 10% is applied.
Debts from previous years must be paid immediately to avoid additional interest.

TË PLOTËSOHET NGA BANKA / POPUNJAVA BANKA / TO BE COMPLETED BY BANK

Shuma e Paguar/Plaćeni Iznos/Amount Paid: _____ Komuna/Opština/Municipali Pejë
Data e Pagesës/Datum Plaćenja/Payment date: _____ Emri i Tatimpaguesit/ime Poreznika/Taxpayer Name
Emri i Bankës/Ime Banke/Bank Name: _____ N.H.T.T. "RUGOVA" PEJË
Nr. i Llogarisë/Br.žiro Raçuna/Account No: 1000650210000025 Nr. faturës / Br Raçuna / Bill No 117837 / 3171756



Pejë
Peç

Fatura për Tatimin në Pronë
Raçun o Porez na Imovinu
Property Tax Bill



N.H.T.T. "RUGOVA" PEJË
122/2 MBRETËRESHA TEUTË, 49, 49
30000 Pejë/Peç
PEJË/PEÇ

Data e feshimit të faturës:
Datum izdanje računa: **2010-12-07**

INFORMATAT E PRONËS / INFORMACIJE ZA IMOVINU / PROPERTY INFORMATION

Sipërfaqja Površina Area	Kategoria e pronës Vista imovine Property Category	Zona e Vlerësimit Porezka Zona Value Zone	Vlera e Llogaritur Raçunata Vrednost Appraised Value	Zbritja për Banim Kryesor Sniženje za Glavno Boravište Principle Residence Deduction	Norma Tatimore Porezka Stopa Tax Rate
20 m ²	Për Atanzëm	I	€ 60.400	€ 0	0.15 %

INFORMATAT FINANCIARE / FINANCIJSKE INFORMACIJE / FINANCIAL

1384/1

Për pronën tuaj për vitin 2010 është vlerësuar tatimi 120.60
 Za vašu imovinu za 2010 godine procenjen je 120.60
 For your property the assessed tax for 2010 120.60

Shumat dhe datat e pagesës / Iznos da se plati / Amounts and payments dates

Specifikimi specifikacija Specification	Afati i Pagesës Rok Plaćenje Due Date	Shuma Iznos Amount
Tatim 2010 Kesh / Para Porez 2010 Prva Rata Tax 2010 First Installment	30 Qershor 30 Jun June 30	60.30
Tatim 2010 Kesh / Detyr Porez 2010 Druga Rata Tax 2010 Second Installment	31 Dhjetor 31 Decembar December 31	60.30
Birori nga vitet e kaluara përfshinë kamaten dhe dënimet Dovršeni prethodnih godina obuhvata kamate i kazne Out from previous years including interest and penalties	Paguani menjëherë Platite odmah Pay immediately	1.180.48
Totali / Total / Total		1281.08

Ukoliko plaćanje iznosi kamata prej 1% dhe dërimi prej 5%. Nëse pagesa vonohet më shumë se 60 ditë, do të llogaritet edhe 10% dënim shtesë
 Ukoliko plaćanje iznosi kamata od 1% i kazna od 5%. Ukoliko zakasniše više od 60 dana, izračunava se dodatno, zatezna kamata do 10%

Ukoliko plaćanje iznosi kamata od 1% i kazna od 5%. Ukoliko zakasniše više od 60 dana, izračunava se dodatno, zatezna kamata do 10%

Ukoliko plaćanje iznosi kamata od 1% i kazna od 5%. Ukoliko zakasniše više od 60 dana, izračunava se dodatno, zatezna kamata do 10%

TRIMTOHET NGA BANKA / POPUNJAVA BANKA / TO BE COMPLETED BY BANK

Shuma e Paguar/Placeni Iznos/Amount Paid _____ Komuna/Opština/Municipali Pejë
 Data e Pagesës/Datum Plaćenja/Payment date _____ Emri i Tatimpaguesit/Ime Poreznika/Taxpayer Name
 N.H.T.T. "RUGOVA" PEJË
 Emri i Bankës/Ime Banke/Bank Name: _____ Nr.faturës / Br Raçuna / Bill No
 Llogarise/Brçina Raçuna/Account No: 1000650210000025 117837 / 3171758



Fatura për Tatimin në Pronë
Raçun o Porez na Imovinu
Property Tax Bill



Pejë
Peç

N.H.T.T. "RUGOVA" -PEJË
122/2 MBRETËRESHA TEUTË, 49, 49
30000 Pejë/Peç
PEJË/PEÇ

Data e lëshimit të faturës:
Datum izdanje računa: 2010-12-07

INFORMATAT E PRONËS / INFORMACIJE ZA IMOVINU / PROPERTY INFORMATION

Niveli i Sipërfaqja E vendit Area	Kategoria e pronës Vista imovine Property Category	Zona e Vlerësimit Porezka Zona Value Zone	Vlera e Llogaritur Raçunata Vlerdnost Appraised Value	Zbritja për Banim Kryesor Sniženje za Glavno Boravište Principle Residence Deduction	Norma Tatimore Porezka Stopa Tax Rate
45 m ²	Per Apartëm	I	€ 54.000	€ 0	0.15 %

INFORMATAT FINANCIARE / FINANCIJSKE INFORMACIJE / FINANCIAL

1384/1

Tatimi për pronën tuaj për vitin 2010 është vlerësuar tatimi	81.00
Ta vaša imovina za 2010 godine procenjen je	81.00
For your property the assessed tax for 2010	81.00

Tërmat dhe datat e pagesës / Iznos da se plati / Amounts and payments dates

Tipi i Tërmit Specifikacija Specification	Afati i Pagesës Rok Plaćenje Due Date	Shuma Iznos Amount
Tatimi 2010 Kësti i Parë Tatim 2010 Prva Plata Tax 2010 First Installment	30 Qershor 30 Jun June 30	40.50
Tatimi 2010 Kësti i Dytë Tatim 2010 Druga Plata Tax 2010 Second Installment	31 Dhjetor 31 Decembar December 31	40.50
Tatime të mëhershme të vitit - krahëzime përfitime kamates dhe dënimet Tatime prethodnih godina obuhvata kamata i kazne Tax from previous years including interest and penalties	Paguani menjëherë Plati odmah Pay Immediately	779.37
Total / Total		860.37

Interesi i vjetër dhe dënimet kamata prej 1% dhe dënim prej 5%. Nëse pagesa vonohet më shumë se 60 ditë, do të llogaritet edhe 10% dënim shtesë.
Old interest and penalties including interest and penalty of 5%. If payment is delayed more than 60 days, an additional penalty of 10% is applied.

Interesi i vjetër dhe dënimet kamata od 1% i kazna od 5%. Ukoliko zakasnite više od 60 dana, izračunava se dodatno, zatezna kamata do 10%.

Old due date interest of 1% and penalty of 5% is applied. If payment is delayed more than 60 days an additional penalty of 10% is applied.
Old due date interest of 1% and penalty of 5% is applied. If payment is delayed more than 60 days an additional penalty of 10% is applied.

POLOTËSOHET NGA BANKA / POPUNJAVA BANKA / TO BE COMPLETED BY BANK

Shuma e Paguarit / Iznos / Amount Paid: _____ Komuna/Opština/Municipali Pejë
Emri i Tatimpaguesit/Ime Poreznika/Taxpayer Name
Emri i Pagimit/Datum Plaćenja/Payment date: _____ N.H.T.T. "RUGOVA" -PEJË
Emri i Bankës/Ime Banke/Bank Name: _____ Nr.fatures / Br Raçuna / Bill No
Emri i Llogarisë/Br. i Raçuna/Account No: 1000650210000025 117939 / 9171768



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

KONTRATË PËR QIRANË E LOKALIT AFARIST

Drejtoria për çështje pronësoro- juridike KK Pejë

E lidhur me datë 28.03.2011 në Pejë, ndërmjet:

*1. Komunës së Pejës të cilën e përfaqëson Mr. Afrim Selimaj
Drejtor për çështje Pronësoro-Juridike si qeradhënës, nga
njëra anë dhe*

2. Agron Berisha si qiramarrës nga ana tjetër, si vijon

Palët kontraktuse janë marrë vesh si vijon:

Neni 1.

1.1. Qiradhënësi ia lëshon qiramarrësit në qira lokalit afarist që ndodhet në rrugën M Teuta lokalit me sipërfaqe prej 68 m² x 8 € për m² (zona e parë), sipas Rregullores mbi Ndreyshimin dhe plotësimin dhe Rregullores Mbi Tarifat, Taksat dhe Gjobat e miratuar nga Asambleja Komunale me datë 06.03.2006.

Neni 2.

2.1. Qiramarrësi merr me qira lokalit afarist që ndodhet në nenin 1. të kësaj kontrate me detyrimin që të paguaj qiranë mujore prej 544. €

Neni 3.

3.1. Marrëdhëniet e qirasë rrjedhin prej datës 01.04.2011 deri 01.07.2011.

Neni 4.

4.1. Secili kontaktues mund ti japë tjetrit DENONCIMIN gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënjes kontraktuse ashtu që afati nuk mund të jetë me shkurët se 30 ditë.

Neni 5.

5.1. Qiraja mujore ka vlerën mujore prej 544 €

5.2. Qiraja mujore do të paguhet sipas fletpagesave të marrura në drejtorat.

Neni 6.

6.1. Qiramarrësi është i detyruar që qiranë mujore ta paguaj në afat 5 ditor.

Neni 7.

7.1. Qiramarrësi deklaron se lokalim afarist e ka pranuar në gjendje të rregullt dhe detyrohet që atë ta ruaj dhe të kujdeset si ekonomist i mirë dhe më rastin e shuarjes së marrëdhënies kontraktore t'ia dorëzoj qiradhënësit në gjendje të rregullt e për çdo dëm eventual qiramarrësi përgjigjet sipas rregullave të Ligjit Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Neni 8.

8.1. Qiramarrësi lokalim afarist gjatë rrjedhës së qirasë nuk mund ta jep në shfrytëzim (me kontratë të nënqirasë) palës së tretë.

Neni 9.

9.1. Qiramarrësi është i detyruar ti paguaj shpenzimet e enërgjisë elektrike, të ujit, të telefonit, për të cilat janë pajtuar palët kontraktuese që në fillim të lidhjes së kësaj kontrate.

Neni 10.

10.1. Kjo kontratë quhet e lidhur ditën e nënshkrimit të saj nga palët kontraktuese.

Neni 11.

11.1. Në rast kontesti kompetent është Gjykata lëndore në Pejë.

Neni 12.

12.1. Kjo kontratë është lidhur në dy kopje identike, prej të cilave secili nga palët e mbajn nga një kopje.

PALËT KONTRAKTUSE

QIRAMARRËSI

Agron Berisha

QIRADHËNËSI

Mr. Afrim Selimaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

Drejtoria për Çështje Pronëso-ro-Juridike KK Pejë

Datë: 26.05.2011

Për: Agron Berisha

NJOFTIM

Ju njoftojmë se me datë 25.05.2011 është hapur konkursi për marje me qera të dyqanit në rrugën "Mbretresha Teuta" dyqani pa numër me Fletë Poseduse 715 ngastra kadastrale nr. 687/4, pronë e KK Pejë. Përfituesi nga ankandi publik do të ketë të drejten e shfrytëzimit të dyqanit, ankand është i hapur deri më datën 10.06.2011, ju keni të drejtën të konkuroni.

DREJTORI

Mr. Afrim Selimaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DREJTORIA PËR ÇËSHTJE PRONËSORO-JURIDIKE

Drejtoria për Çështje Pronësoro-Juridike, duke vepruar konform nenit 37. dhe nenit 84,1 të Ligjit mbi Procedurën Administrative të Kosovës nr. 02/1-28 në mbështetje të ligjit mbi shqyrtimin e marrëdhënjeve pasurore të krijuara me uzurpim arbitrar të tokës në pronësi shoqrore të nenit 16, nenit 18, dhe në mbështetje të nenit 14 të Ligjit mbi vetqeverisjen lokale, në çështjen administrative lidhur me objektin "Dyqanin" në rrugën "Mbretresha Teuta" e që është pronë e KK Pejë.

AKTVENDIM

I. Urdhërohet:

- Agron Berisha nga Peja

Që në afat prej 15 ditësh, ta liroj dyqanin që e ka uzurpuar në rrugën "Mbretresha Teuta" dyqani pa numër në Pejë.

- II. Dyqani duhet të zbrazet nga të gjitha paisjet dhe inventari personal, në të kundërtën gjërat do të largohen nga dyqani i Komunës i cili nuk do të përgjigjet për dëmtimin e tyre.
- III. Pas lirimit dyqani duhet të lihet në gjendje të rregullt, në të kundërtën ju keni shkaktuar dëm të pronës Komunale dhe mund të ndiqeni penalishtë.

Në bazë të ligjit të procedurës Administrative neni 99 pika 99.4: Ankimi nuk e shtyn ekzekutimin.

Arsyetim

Komuna e Pejë duke u bazuar në dispozitat e nenit 14.2 të Ligjit mbi vetqeverisjen lokale, ku i liden të drejtat Komunës se mund të shes apo të jap me qera pasuritëe luajtshme dhe të paluajtshme, dhe të ligjit mbi shqyrtimin e marrëdhënjeve pasurore të krijuara me uzurpimin arbitrar të tokës në pronësi shoqrore, në mbështetje të nenit 16, dhe nenit 18 të këtij ligji.

Andaj, pasi që Dyqani në rrugën "Mbretresha Teuta" ngastrada kadastrale nr. 687/4 është pasuri e paluajtshme e Komunës me Vendim të Bordit të Drejtorve është aprovuar kërkesa e Drejtoratit për Çështje Pronësoresho-Juridike për dhënjen në shfrytëzim me qera.

Dhe pasi që pala është njoftuar me fletëdorzim me datë 25.02.2011, me datë 10.03.2011 dhe me datë 25.03.2011, që të paraqitet në Drejtoratin për Çështje Pronësoresho-Juridike për të u njoftuar se pas dokumentacionit të kompletuar është evidentuar se dyqani që e keni në shfrytëzim është pronë e KK Pejë, dhe është informuar se do të hapet ankandë publik për dhënjen me qera në bazë të ligjit paia e lart përmendur nuk ka pranuar.

Andaj, me datë 12.04.2011 është njoftuar për herë të dytë se në rastë të mos paraqitjes së ti në afat prej 3 ditëve në Drejtoratin për Çështje Pronësoresho-Juridike do të lëshojmë fletë padinë për mos shlyerje të obligimeve për shfrytëzim të dyqanit, dhe me datë 26.05.2011 është njoftuar se është hapur ankandë publik dhe nuk i është përgjigjur organit përgjegjës për legalizim të qëndrimit në atë dyqan.

Meqenëse ju e posedoni një Vendim nga KK Pejë të datës 27.12.1999 në pikën III të dispozitivit të këtij vendimi, shfrytëzuesi është i obliguar që të lidhë kontratën mbi qerën për shfrytëzim të lokalit nga pika I e vendimit në kshillin komunal Pejë, në kohë të caktuar deri në një vit në të drejtë të vazhdimit të saj.

Ndërsa ju keni qenë të obliguar që të lidhni kontratë për shfrytëzim dhe të njejtën kohë të bëni pagesën e qerave mujore, me rastin e mos lidhjes së kontratës ju e keni humbur edhe të drejtën e shfrytëzimit të dyqanit dhe nga momenti i humbjes së kësaj të drejte ju cilsoheni si uzurpues i pronës Komonale.

Njëkosishtë Drejtorati për Çështje Pronësoresho-Juridike, Drejtoria për Punë Inspektive është e obliguar që të ndërmarin veprimin të nevojshme për lirim të dyqanit. Nga të cekurat më lartë dhe në kuptim të nenit 12.37, 76 dhe 84.1 të Ligjit për Procedurën Administrative të Kosovës nr. 02/L-28, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

KËSHILL JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi pala ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, në Gjykatën Komonale.

Nr. 15-463/59/2011

Datë: 14.09.2011

Zyrtari Ligjor për Çështje Pronësoresho-Juridike

Z. Guan Gashi



DREJTORI
Mr. Afrim Selimaj





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ
DREJTORATI PËR ÇËSHTJE PRONËSORO-JURIDIKE

Drejtorati për Çështje Pronësoro-Juridike duke vepruar sipas detyres zyrtare per permbarimin e Aktvendimit te plotefuqishem te Drejtorati për Çështje Pronësoro-Juridike me nr prot.15-463/59/2011 të datës 14.09.2011 e me qellim te largimit te uzurpimit arbitrar, duke vepruar konform nenit 37, dhe nenit 84,1 të Ligjit mbi Procedurën Administrative të Kosovës nr. 02/1-28 në mbështetje të ligjit mbi shqyrtimin e marrëdhënjeve pasurore të krijuara me uzurpim arbitrar të tokës në pronësi shoqrore të nenit 16, nenit 18, dhe në mbështetje të nenit 14 të Ligjit mbi vetqeverisjen lokale, në çështjen administrative lidhur me objektin Dyqanin "Doner" në rrugën "Mbretresha Teuta" e që është pronë e KK Pejë, merr:

Konkluzion për lejim ekzekutimi

- I. Lejohet ekzekutimi i Aktvendimit të Drejtorati për Çështje Pronësoro-Juridike me nr te prot. 15-463/59/2011 të datës 14.09.2011 Ekzekutimi do të zbatohet me datë 14.11.2011 duke filluar ne ora 10 në dyqanin "Doner" pa numër në rrugën "Mbretresha Teuta" për largimin e uzurpuesit të dyqanit Komunal.*
- II. Pala e njoftuar me këtë konkluzion është e obliguar që në datën dhe në orën e caktuar më lartë të jetë prezent gjate ekzekutimit.*
- III. Uzurpuesi mund ta liroj dhe ti heqë të gjithë sendet personale dhe inventarin e dyqanit, dhe të i dorzoj qelsat e dyqanit në Drejtorinë për Çështje Pronësoro-Juridike para afatit të lartëpërmendur, në të kundërtën gjat ekzekutimit Komuna nuk përgjigjet për dëmet e shkaktuara për largimin e gjësendeve dhe inventarit të vendosur.*

Arsyetim

Dyqani në rrugën "Mbretresha Teuta" në ngastrëa kadastrale nr. 687/4 është pasuri e paluajtshme e Komunës me Vendim të Bordit të Drejtorve është aprovuar kërkesa e Drejtoratit për Çështje Pronësoro-Juridike për dhënjën në shfrytëzim me qera, ku jan kryer të gjitha procedurat e tenderimit.

Pala është njoftuar me fletëdorzim me datë 25.02.2011, me datë 10.03.2011 dhe me datë 25.03.2011, që të paraqitet në Drejtoratin për Çështje Pronësoro-Juridike për të u njoftuar se pas dokumentacionit të kompletuar është evidentuar se dyqani që e ka në shfrytëzim është pronë e KK Pejë, dhe është informuar se do të hapet ankandë publik për dhënjën me qera në bazë të ligjit pala e lart përmendur nuk ka pranuar.

Pastaj, me datë 12.04.2011 është njoftuar për herë të dytë se në rastë të mos parqitjes së ti në afat prej 3 ditëve në Drejtoratin për Çështje Pronësoro-Juridike do të lëshojmë flet padin për mos shlyerje të obligimeve për shfrytëzim të dyqanit, dhe me datë 26.05.2011 është njoftuar se është hapur ankandi publik dhe nuk i është përgjigjur organit përgjegjës për legalizim të qëndrimit në atë dyqan.

Pala e posedoni një Vendim nga KK Pejë të datës 27.12.1999 në piken III, ku në dispozitiv të këtij vendimi, shfrytëzusi është i obliguar që të lidhë kontratën mbi qëran për shfrytëzim të lokalit nga pika I e vendimit në kshillin komunal Pejë, në kohë të caktuar deri në një vit në të drejtë të vazhdimit të saj, ku ju nuk jeni përgjegjës,

me rastin e mos lidhjes së kontratës ju e keni humbur edhe të drejtën e shfrytëzimit të dyqanit dhe nga momenti i humbjes së kësaj të drejte ju cilsoheni si uzurpues i pronës Komunale.

Pala ka ushtruar Ankes pran Agjencionit Kadastral të Kosovës kundër aktvendimit nr. 15-463/59/2011 të datës 14.09.2011 të Drejtorisë për Çështje Pronësoro-Juridike, ku i është refuzuar ankesa pasi që AKK-ja ka konstatuar se organi i shkallës së parë ka marr aktvendimin në bazë të nenit 16, 17, 18 të Ligjit mbi shqyrtimin e marrëdhënjeve, duke e shpallur uzurpues arbitrar të pronës shoqrore të përsjkruar më për së afërmi në dispozitiv të vendimit të atakuar.

Njëkosishtë Drejtorati për Çështje Pronësoro-Juridike, Drejtoria për Punë Inspektive është e obliguar që të ndërmarin veprime të nevojshme për lirim të dyqanit.

Nga të cekurat më lartë dhe në kuptim të nenit 12.37, 76 dhe 84.1 të Ligjit për Procedurën Administrative të Kosovës nr. 02/L-28, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Nr. 15-463/59/2011

Datë: 08.11.2011

Zyrtari Ligjor për Çështje Pronësoro-Juridike

Z. Luan Gashi



DREJTORI
Mr. Afrim Selimaj



PER: DREJTORIA PER QESHTJE PRONESORO - JURIDIKE KK PEJE

NGA: DREJTORIA PER KADASTER DHE GJEODEZI

LEND A: Historiku i ngastres kadastrale nr. 687/4 ne K.k. Peje

Data: 09.06.2011 vit.

Ne lidhe me shkresen e juaj ref. zyrtarisht te dt. 08.06.2011 vit. e ne lidhje me historikun e ngastres kadastrale nr. 687/4 JU dergojme raporti:

Sipas evidencenz syrtare me te cilen disponon kjo Drejtori, ngastra kadastrale nr. 687 (shtepi-0.03.59.ha, oborr-0.05.00.ha dhe are-0.14.77.ha) ne siperfaqe prej 0.23.36.ha me reambulimin e kadastrit nga viti 1955 - 1956 regjistrohet ne emer te Markoviq Marka Kosta nga Peja sipas fleteposedimit nr. 302 K.k. Peje . .

Sipas regjistrimit te ndrimeve nr. 132/1963 ngastra nr. 687 ne tere siperfaqen e saj regjistrohet ne emer te : Joksimovic Milan, Joksimovic Miodrag dhe Joksimovic Mirko sipas fleteposedimit nr. 4214 K.k. Peje (regjistrimi u be ne baze te Aktvendimit bashigjitor T.nr. 200/62 te dt. 26.02.1963) .

Ne vitin 1966 sipas regjistrimit te ndrimeve nr. 311/66 ngastra nr. 687 ndahet ne dy pjese : ne ngastren nr. 687/1 ne siperfaqe prej 0.10.06.ha e cila mbetet ne pronesi tek gjertanishmit, ndersa ngastra e posafomuara nr. 687/2 ne siperfaqe prej 0.13.30.ha regjistrohet ne emer te Kooperatives byjqsore - Peje sipas fleteposedimit nr. 1819 K.k. Peje . (ndrimit u be ne baze te kontrates nr. 1475/66) .

Sipas regjistrimit te ndrimeve nr. 139/91 ngastra kadastrale nr. 687/2 me tere siperfaqen e saj ndahet ne ngastret : 687/2 ne siperfaqe prej 0.10.51.ha , nr. 687/3 ne siperfaqe prej 0.01.41.ha, nr. 687/5 ne siperfaqe prej 0.00.60.ha te cilat mbesin ne pronesi te Kooperatives bujqesore Peje, ndersa ngastra nr. 687/4 ne siperfaqe prej 0.00.78.ha regjistrohet ne fleteposedimit nr. 715 K.k. Peje ne emer te : Keshilli komunal i SPS- Peje (ndrimit u be ne baze te kontrates mbledhese se drejtes se shlytezimit nr. 03-466/34 te dt. 20.09.1991 vit)

Sot ngastra kadastrale udhheqet ne emer te : P.SH. Organi Drejtues i Komiteit komunal i lidhjes komuniste - Peje sipas fleteposedimit nr. 715 K.k. Peje .

Raporti i dergohet organit te lartecukur.

E punoi

Samir Krasniqi jur. dipl.

DREJTORI
Besim Kujbegollu i.t.a.

AGJENCIONIT KADASTRAL TË KOSOVËS



Përmes: Drejtorisë për çështje pronësore juridike të Komunës së Pejës;

Parashtrues: Agron BERISHA, Rruga "Bedri Shala" nr.3, Pejë.

ANKESË

Kundër aktvendimit të Drejtorisë për çështje pronësore juridike të Komunës së Pejës, nr.15-463/59/2011, të datës 14.09.2011.

Për shkak të: Vertetimit të gabuar të gjendjes faktike; Shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale; dhe Zbatimit të gabuar të dispozitave të ligjit material.

(dorëzuar në dy kopje identike)

Me 14.09.2011, Drejtoria për çështje juridiko pronësore e Komunës së Pejës, ka lëshuar aktvendimin nr.15-463/59/2011, sipas të cilit mes tjerash, parashtruesi i kësaj anekese urdhërohet që në afat prej 15 ditësh, ta liroj dyqanin e uzurpuar në rrugën Mbretëresha Teutë, pa numër. Parashtruesi konsideron se aktvendimi në rastin konkret, është rezultat i një procesi plotësisht të paligjshëm dhe i veprimeve arbitrare të zyrtarve të Komunës së Pejës, së paku për shkaqet dhe arsytet si në vijim:

1. Në mungesë të institucioneve të rregullta, respektivisht me pëlqimin e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, Komisionit përkatës të KK Pejë, parashtruesi i ankesës kishte hyrë në posedim të objektit kontestues i cili ishte në tërësi i shkatërruar dhe i pa përshtatshëm për ushtrimin e çfarëdo veprimtarie afariste. Drejtoria për çështje pronësore juridike të Komunës së Pejës, ka bërë vlerësim të gabuar të gjendjes faktike dhe në mënyrë fare të pandërgjegjshme çështjen në rastin konkret e ka kualifikuar në vështrim të uzurpimit arbitrar. Provat në disponim, rrethanat faktike, natyra dhe historiat i çështjes në rastin konkret, në asnjë mënyrë nuk i japin të drejtë këtij organi që një titullar të ligjshëm të së drejtës së shfrytëzimit ta kualifikoj si uzurpues.
2. Parashtruesi i ankesës, me vite të tëra ka kërkuar titullarin e vërtetë të këtij objekti me ç'rast në disa raste zyrtar të Komunës së Pejës kanë deklaruar se: Lokali lëndor nuk është pronë e Komunës. Parashtruesi i ankesës ka kontaktuar në disa raste udhëheqës të ndërmarrjeve shoqërore dhe të njëjtët kanë deklaruar se: Lokali lëndor nuk është pronë e tyre. Parashtruesi ka kontaktuar po ashtu në disa raste, nëpunës të ish-Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit të cilët kanë deklaruar se, nuk kanë prova se lokali lëndor bije nën juridiksionin e tyre/saj.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO				
KOMUNA E PEJËS - OPSTINA FEE - OPGINA PEC				
DREJTORIA - DIREKTORAT				
Nr i Protokollit Organitave	Nr i Protokollit te shprehjes	Nr ifaqeve	Data	Vendi
Detyrimi për Organizimin	Detyrimi përfaqësues	Detyrimi përfaqësues	Datum	Mesto

3. Me aktvendimin e atakuar, Drejtoria për çështje pronësore juridike të Komunës së Pejës, ka urdhëruar që (citoj): "...parashtruesi i ankesës ta liroj dyqanin që e ka uzurpuar në afat prej 15 ditësh..." gjë që, lëshimi i një urdhëri tillë as nuk ka bazë ligjore e as që duhej të ndodhte. Në të vërtetë, Drejtoria për çështje pronësore juridike e Komunës së Pejës, ka injoruar plotësisht ç' do fakt, provë, shpjegim apo dëshmi të ofruar nga parachtruesi kurse, vendimin e vitit 1999, zyrtarët të Komunës e kanë shikuar me injorancë dhe asnjëherë nuk e kanë konsideruar si akt admnisatrativ mu për shkak të organit i cili e ka nxjerrë. Mirëpo tani në mungesë të ndonjë prove, po të njëjtin vendim e kanë shfrytëzuar vetëm për shkaqet e arsytimit të vendimit të sulmuar. Një qasje e tillë dhe e dyanashme e kësaj Drejtorie tejkalon parimet e Kodit të Etikës Profesionale.

4. Në hyrje të arsytimit theksohet mes tjerash se, Komuna e Pejës duke u bazuar në dispozitat e nenit 14.2 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale mund ta shes apo ta jap me qera pronën e lujatshme dhe të paluajtshme. Është e vërtetë se, Komuna e Pejës ka të drejtë të ushtroj këto të drejta mbi pronën e cila udhëhiqet dhe regjistrohet në emër të saj, por këto të drejta nuk i ka ndaj pronës së huaj. Në arsyetim e akvendimit të atakuar theksohet më tej se (cituar): "...me Vendimin e Bordit të Drejtorje është aprovuar kërkesa e Drejtoratit për çështje pronësoro juridike për dhënje në shfrytëzim të lokalit me qera". Shtrohet pyetja: cili lokal të ipet me qera? Lokali lëndor nuk është e Komunës së Pejës dhe mëqë nuk është pronë e Komunës, Bordi i Drejtorve nuk ka të drejtë që lokalet e huaja ti ofroj me qera.

5. Edhe përkundër faktit se, se persona të caktuar autorizimet e besuara i përdorin në mënyrë jo të drejtë, prapseprap Drejtoria për çështje pronësore juridike nuk ka të drejtë që të lëshoj një urdhër të tillë ultimativ sepse Komuna e Pejës asnjëherë deri më tani, nuk e ka ofruar asnjë provë të vetme e cila e dëshmon pronësinë, pretendimet apo çfarëdo interesi juridik të Komunës mbi këtë lokal. Prandaj, çfarëdo vendimi eventual i Bordit të Drejtorve për dhënjen e lokalit konkret me qera nuk ka bazë ligjore kurse, Drejtoria për çështje pronësore juridike nuk ka pasur dhe nuk ka fare të drejtë të urdhëroj ashtu në mënyrë aq arbitrare lirimim e lokalit nga cilido shfrytëzuesi i ligjshëm dhe me mirëbesim.

6. Askund dhe me asnjë ligj, nuk i është dhënë e drejta Bordit të Drejtorve të ndonjë Komune që të vendos lidhur me fitimin ose humbjen e të drejtave pronësore. Fitimi ose humbja e pronësisë është çështje e Ligjit mbi të drejtat sendore dhe të drejtat tjera reale, e jo çështje e vendimit të bordit ose drejtoratit të ndonjë komune. Prandaj të gjitha veprimet e përshkruara në arsytimin e Vendimit të atakuar dhe ultimatumi për lirimim e lokalit, përbëjnë veprime presioni mbi parachtruesin e kësaj ankese për të hekur dorë nga posedimi dhe përbëjnë një skenar jo të ndershëm nga Drejtoria për çështje pronësore juridike.

7. Është fakt notor se, lokali lëndor ka qenë i shkatërruar dhe i shëndërruar në një rezervat hedhurinash por po ashtu publikisht është e ditur se të njëjtin, jo Komuna, por ankuesi e ka ndërtuar, renovuar dhe e ka përshtatur për ushtrimin e ndonjë veprimtarie afariste. Për aftësimin

e këtij lokali parashtruesi ka shpenzuar një shumë të konsiderueshme të mjeteve financiare dhe me të drejtë konsideron se, është pronar legjitim i investimeve të tija.

8. Është e vërtetë se në vitin 1999, parashtruesi i është drejtuar Komunës së Pejës me kërkesë për lejimin e shfrytëzimit të lokalit me qera. Por kërkesa e një qytetari drejtuar organit nuk e shpallë atë organ si pronar të ndonjë pasurie. Me Ligjin mbi të drejtat sendore dhe të drejtat tjera reale, parashifen saktësisht se cilat janë mënyrat e fitimit të pronësisë. Shtrohet pyetja: Mbi cilën nga këto baza ligjore Komuna e Pejës është pronare e lokalit lëndor? Vendimi i vitit 1999 është lëshuar në rrethanat e konsolidimit fillestar të pushtetit shtetëror në Kosovë mirëpo është e pakontestueshme se ky vendim është lëshuar nga jo pronari. Drejtoria për çështje pronësore juridike nuk mund ta deklaroj vetën pronare të ndonjë aseti me një vendim të tillë.

9. Kohë më parë, si pasojë e imponimit nga zyrtarët e Komunës së Pejës, parashtruesi kishte pranuar nga Drejtori i Drejtorisë për çështje pronësore juridike, një kopje të kontratës për qeranë. Lidhur me këtë kontratë parashtruesi është informuar nga burime të ndryshme se, kontrata në rastin konkret e përpiluar nga Drejtoria për çështje pronësore juridike e Komunës së Pejës, nuk mund të vertetohet/legalizohet meqë Komuna e Pejës nuk mund të legjitimohet si palë kontraktuese.

10. Për shkak të rrethanave të përshkruara si më sipër parashtruesi ka ushtruar padi në Gjykatën Komunale të Pejës për vertetimin e pronësisë për lokalin dhe investimet në rastin konkret. Meqë për të njëjtën çështje dhe në të njëjtën kohë, nuk mund të udhëhiqen dy procedura paralele para dy organeve, Drejtoria për çështje pronësore juridike e Komunës së Pejës, është e detyruar që ti ndërpresë të gjitha veprimet deri sa, gjykata kompetente të vendos meritorisht lidhur me çështjen juridiko civile në rastin konkret. Sipas nenit 17.1. të Ligjit mbi procedure administrative “Në rast kur vendimi përfundimtar në procedim administrativ kushtëzohet ngamarrja e një vendimi paraprak, i cili, nga ana e tij, është në kompetencë të një organitjetër të administratës publike ose të gjykatës, organi që është kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar pezullon procedimin administrativ derisa organi tjetër ose gjykatatë marrin vendimin paraprak”.

11. Duke ju referuar shkurtimisht të lartëcekurave, parashtruesi i ankesës konsideron se Aktvendimi i Drejtorisë për çështje pronësore juridike të Komunës së Pejës, nr.15-463/59/2011, i datës 14.09.2011, përmban dhe një varg tjerë të shkeljesh procedurale, vertetim të gabuar të gjendjes faktike dhe për pasojë aplikim të gabuar të dispozitave të karakterit material, të gjitha këto në dëm të parashtrësit. Prandaj bazuar në të lartëcekurat, parashtruesi i drejtohet urgjentisht Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK) në mënyrë që sa më parë që të jetë e mundur, AKK ti vlerësoj të gjitha provat e bashkangjitura, natyrën urgjente të çështjes dhe të marri:

AKT V E N D I M


PEZULLOHET zbatimi i Aktvendimit të Drejtorisë për çështje pronësore juridike të Komunës së Pejës, nr.15-463/59/2011, i datës 14.09.2011, përderisa çështja administrative në rastin konkret është objekt i vlerësimit dhe vendosjes nga ana e Gjykatës Komunale të Pejës;

Bashkangjitur:

1. Kërkesa e parashruesit nr.07-353-1930/99, datë 16.11.1999;
2. Vendimi i Komisionit për evidentimin dhe mbrojtjen e pronës shtetërore dhe private i Këshillit Komunal të Pejës, nr. 07-353-1930/99, i dates 27.12.1999;
3. Qertefikata (historiati) i ngastrës kadastrale nr.01-3-2242, dt.30.09.2003;
4. Një qertefikatë e tatmit në pronë në emër të NSH Rugova;
5. Vendimi i atakuar i Drejtoratit për çështje pronësoro juridike, KK Pejë, nr.15-463-59/2011, i datës14.09.2011;
6. Draft-Kontratë e ish-Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit;
7. Padia (dhe shkresat) e ushtruar në Gjykatën Komunale të Pejës, C.nr.562/11



Datë 21.09.2011

Parashtruesi i ankesës



AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS

Numri 03/1047/11
17-10-11

Emri i shkresës	Kujt i dërgohet shkresa		Data e marrjes dhe nënshkrimi i marrësit	Nënshkrimi i dorëzuesit
	Emri dhe mbiemri	Rruga dhe numri (Vendbanimi)		
AKTIVENDIM	AGRON BERISHA	PEJE		 22.01.2012 2013

gabim



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada-Government

**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog
Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning**

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

DATË/A:	17.10.2011
REFERENC-Ë:	03/1047/11
PËR/ZA/TO:	1. Drejtoria për Çështje Pronësoro-Juridike KK. Pejë 2. Agron Berisha Rr. Bedri Shala nr.3. Pejë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Prof. Dr. Murat Meha Kryeshef Ekzekutiv i AKK-s
NGA/OD/FROM:	Drejtor Ligjor i AKK-s Ismet Kryeziu
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Aktvendim

Agjencia Kadastrale e Kosovës, duke u bazuar në dispozitën e Aktit të MSHP të datës 30.01.04; Neni 8 të Ligjit mbi Shqyrtimin e Marrëdhëniet Pronësore-Juridike të Krijuara me Uzurpim Arbitrar të tokës në Pronësi Shoqërore (GZ.nr.46/77) Neni 3 të Ndryshimeve dhe Plotësimeve të Ligjit mbi Shqyrtimin e Marrëdhëniet Pronësore-Juridike të Krijuara me Uzurpim Arbitrar të tokës në Pronësi Shoqërore (GZ.nr.37/88) Neni 136(b) i Ligjit për Procedurën Administrative, duke vendosur në bazë të Ankesës të ushtruar nga Agron Berisha nga Peja me datë 17.10.2011 bie këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHËT : ankesa e Agron Berisha nga Peja, i cili ka bërë ankesë ndaj aktvendimit nr.15-463/59/2011 të dt. 14.09.2011 të Drejtorisë për Çështje Pronësoro-Juridike KK. Pejë si e PA BAZUAR.

ARSYETIM

Ne Agjencinë Kadastrale të Kosovës kemi pranuar ankesën e Agron Berisha nga Peja ,me te cilin ankuesi e kundërshton aktvendimin me nr.15-463/59/2011 të dt. 14.09.2011 me te cilën pala ka qenë shfrytëzues i lokalit por ne hapjen e ankandit publik për dhënje me qëra në bazë të ligjit pala e lart përmendur nuk ka pranuar te jetë prezentë , nga konsiderohet se ai ka hekë dorë nga qëraja qe ka pasur me KK. Pejë dhe me aktvendim të ksaj drejtorie është shpallur uzurpues në pronën shoqërore KK. Pejë në ngastrën kadastrale nr. 687/4 .

Në Drejtoratin Ligjor të AKK-s u shqyrtua ankesa e palës, thëniet ankimore dhe shkresat e lëndës aktvendimi i Drejtorisë për Çështje Pronësoro-Juridike KK. Pejë me nr. 15-463/59/2001 të dt. 14.09.2011.

Prandaj AKK-ja pas analizimit të gjitha shkresave të lëndës ka konstatuar se organi i shkallës së parë ka pruar aktvendim në bazë të nenit 16,17 e 18 të Ligjit mbi shqyrtimin e marrëdhënieve(Gazeta Zyrtare e Kosovës nr. 46/77) duke e shpallur uzurpues arbitrar të pronës shoqërore të përshkruar më për së afërme në diapozitiv të vendimit të atakuar.


Ankuesi përveç thënieve ankimore AKK-s nuk i ka ofruar asnjë provë materiale me te cilën do te mbështet pretendimet e tija dhe te rezultonte ndonjë vendim, tjetër nga vendimi i Komunës së Pejës

Në bazë të shkresave te lëndës dhe provave me te cilat disponon AKK-ja, u vlerësua i bazuar Aktvendimi i atakuar dhe u vendos si në diapozitiv të këtij Aktvendimi i cili është definitiv në procedurën administrative dhe hynë në fuqi nga momenti i procedimit të tij dhe kundër te njëjtit ankesa nuk është e lejuar.

Këshilla Juridike:

Pala e pa kënaqur ka të drejt në afat prej 30 ditëve të ushtroj Padi
Për Konflikt Administrativ në Gjykatën Supreme të Kosovës

Zyrtare e Lart Ligjore
Mejreme Bajrami



Drejtor Ligjor i AKK-s
Ismet Kësvezhi

pala Agron Berisha ne dt. 22.01.2012



GJYKATA KOMUNALE NË PEJË, si civile e shkallës së parë, me gjyqtarin Armend Berisha, në çështjen juridiko - kontestimore të paditësit; Faton Qazim Berisha, nga Peja rr. Bedri Shala, nr.3, kundër të paditurës Komuna e Pejës, e duke vendosur për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, jashtë seance me datë 11.11.2011 bie këtë:

A K T V E N D I M

CAKTOHET masa e përkohshme e sigurisë, kundër të paditurës, Komuna e Pejës.

- I. **INDALOHE**T, të paditurës, Komuna e Pejës, që të ndërmerret çfarëdo veprimi apo aktiviteti të caktuar lidhur me largimin me dhunë të paditësit, nga Lokali Afarist, i cili gjindet në Pejë rr. Mbretresha Teut, pn, i cili shtrihet në palujtëshmerinë e cila evidentohet si ngastër kadastrale, me nr. 687/4, në sipërfaqe të tërësishme prej 0.00,78 ha, e regjistruar në fletën poseduese 715, ZK, Pejë, nga ana e të paditurës apo të autorizuarve të saj.
- II. **DETYROHET**, e paditura Komuna e Pejës, që deri në perfundimin e këtij kontesti, me vendim të formës së prerë, apo deri në një vendim tjetër të kësaj gjykate, që të mos ndermerret kurrfarë veprimesh- të përshkruara si në pikën I, në këtë çështje kontestuese, nën kercenim të pasojave procedurale.
- III. Ky aktvendim menjëherë do të dorëzohet palëve, avokatit publik komunal, Drejtorisë për Çështje Pronësore-Juridike, pranë KK- Pejë, dhe Kryetarit të Komunës.

A r s y e t i m

Paditësi me padi pranë kësaj gjykate kundër të paditurës ka ushtruar padi për vërtetimin e pronësisë dhe dorëzimin e saj, e cila palujtshmëri evidentohet si ngastër kadastrale me nr. 687/4, në sipërfaqe të tërësishme prej 0.00, 78 ha, e regjistruar në fletën poseduese me nr. 715 ZK, Pejë..

Paditësi me parashtrën e dt. 11.11.2011, ka kërkuar që në këtë çështje juridiko kontestimore të caktohet masa e përkohshme në atë mënyrë që të paditurës ti ndalohet të paditësit që të ndermerret çdo veprim apo aktiviteti të caktuar lidhur me largimin me dhunë të paditësit nga Lokali Afarist të përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, në bazë të Konkluzionit me nr. 15-463/59/2011, të datë 14.09.2011, të lëshuar nga drejtorati për çështje pronësore juridike pranë KK Pejë.

Gjykata duke vendosur lidhur me propozimin e paditësit për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 297 par.1 pika a) dhe b), të LPK-së, i cili shprehimisht parasheh se në çoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshem ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij dhe në çoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së tillë pala kundërshtare do të mund ta veshtronte apo

pamundesont dukshem realizimin e kerkeses, sidomos me tjetersimin e pasurisë së vet, me ngarkim apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen egzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër, do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit, sipas dispozitës së nenit 300.1 pika a), parashihet se për sigurimin e kërkesë së drejtuar, ka sendi i caktuar apo kah një pjesë e tij mund të caktohet masa siguruese që është ndalimi i kundërshtarit të sigurimit që ta tjeterso, fsheh apo disponoj me pasurin ka e cila është drejtuar kërkesa, dhe ky ndalim do të evidedntohet në regjistri publik përkatës, ndërsa në nenin 301.1 pika a) e të njëjtit ligj, shprehimisht parasheh se ndalimi kundërshtarit të sigurimit që të kryej aktivitete e caktuara apo urdhëri që ti kryej aktivitetet e tilla, me qëllim të ruajtjes e gjendjes egzistuese apo pengimin e dëmtimit të palës kundërshtare gjykata mund të caktoi masën e sigutrimit

Gjykata duke u mbeshtetur në dispoziten e nenit 306 par 1 të LPK-së, ku parashihet se gjykata me propozim të propozuesit te sigurimit, mund te caktoi masën e përkohshme të sigurimit pa njoftimin dhe degjimin paraprak të kundërshtarit të sigurimit, po qe se prpozuesi e bënë të besueshem pretendimin, se masa e sigurimit është e bazuar dhe urgjente, dhe se ne te kunderten pa një mase te tillë do të humbë edhe qellimi i kerkespadisë.

Andaj gjykata e vënë para një situatë, pas hetimit paraprak të padisë dhe provave prezentë në lëndë dhe pas vlerësimit të pretendimeve të palës paditëse erdhi në përfundim se në rastin konkret, egziston rreziku qe pa caktimin e një mase te tillë pales paditëse do ti pamundesohëj apo dukshem do ti veshtersohet realizimi i kërkeses- të drejtes se tyre, e sidomose me rastin e largimit me dhunë nga ky lokal, ku do të ndryshohet rrenjesisht gjendja egzistuese, dhe do të shkaktohet dëm i pa riparueshem, duke pasur parasysh se urdheri ka për qëllim ruajtjen e gjendjes egzistuese, ne mënyrë qe palet mos te pesojn dëm. gjykata ka ardhur në përfundim se propozimi për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë është i bazuar.


Andaj duke ju referuar të lart cekurave e duke u mbeshtetur në dispozitat e nenit 297 par 1, pika a) dhe b), nenit 299 par 2, nenit 300 par 1 pika a) nenin 306 par 1 dhe 2, e 387 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

NGA GJYKATA KOMUNALE NË PEJË, me datë 11.11.2011.

KËSHILLA JURIDIKE:

Kunder këtij aktvendimi kundërshtari
I sigurimit mund ti kontestoi shkaqet për
Caktimin e masës së përkohshme siguruese
Në Gjykatën Komonale në Pejë -- gjyqtarit të çështjes.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, 07 prill 2011

Për: Ali Berisha, Kryetar i Komunës së Pejës
Arbëresha Ajdini-Nallbani, Kryesuese e Kuvendit të Komunës

Lënda: Shqyrtimi i ligjshmërisë së Vendimit

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar Vendimin Nr.02-245, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Pejës, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë. Kuvendi i Komunës së Pejës, me datë 02.03.2011 ka nxjerr vendim, që e tërë patundshmëria e ish Koperativave Bujqësore të cilat gjenden në teritorin e Komunës së Pejës, të regjistrohen si pasuri shoqërore në emër të Kuvendit të Komunës së Pejës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në kompetencat dhe afatin ligjor të përcaktuar në nenin 81.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L040, nenit 5 dhe 6 të Ligjit për Agjencionin Kosovar të Privatizimit Nr.03/L-067, Ligjin për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 03/L-226, dhe pas shqyrtimit të hollësishëm të këtij vendimi, ka konstatuar se vendimi është **i kundërligjshëm**.

- Bazuar në nenin 6.1 të Ligjit për Agjencionin Kosovar të Privatizimit Nr.03/L-067, Agjencioni Kosovar i Privatizimit është kompetent për të menaxhuar dhe administruar me pronën shoqërore në tërë teritorin e Republikës së Kosovës, ndërsa vendimi i Kuvendit të Komunës së Pejës është jashtë mandatit dhe kompetencave të Kryetarit dhe Kuvendit të Komunës.

- Bazuar në nenin 9 dhe nenin 10 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 03/L-226, komuna përkatësisht organet komunale për *nevoja publike*, mund të paraqesin kërkesë pranë AKP-së për marrjen e pronës që është nën menaxhimin dhe administrimin e saj, duke kompensuar në bazë të vlerës së tregut apo përmes këmbimit me pronë komunale.

Nga ajo që u tha më lartë dhe me qëllim të zbatimit të plotë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Ligjit për Agjencionin Kosovar të Privatizimit Nr.03/L-067, si dhe Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 03/L-226, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga autoritetet e Komunës, përkatësisht Kryetari dhe Kuvendi i Komunës së Pejës, që bazuar në afatin ligjor të përcaktuar me nenin 82.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, t'i përgjigjet kërkesës për *rishqyrtimin* e vendimit me të cilin e tërë pasuria shoqërore e ish "Koperativave Bujqësore" të cilat gjinden në teritorin e Komunës së Pejës, të regjistrohen si pasuri shoqërore në emër të Kuvendit të Komunës së Pejës, apo të ndërmarr veprime për kompensimin e kësaj prone në pajtim me rregullat ligjore, ose këmbimin e pronës së lartshënuar me pronë komunale.


MAPL, është e përkushtuar të ofrojë përkrahje dhe ndihmë të nevojshme për zbatimin e plotë të këtyre obligimeve që dalin nga legjislacioni i zbatueshëm për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës.

Me respekt,

Sllobodan Petrović

Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL

Kopje: *Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL*
Dino Hasanaaj, Kryetar i Bordit të AKP-së
Shkelzen Lluka, Drejtor Menaxhues i AKP-së
Rozafa Ukimeri, Drejtore e DVL
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Pristina, 07 april 2011

Za: Ali Berisha, Gradonačelnik Opštine Peć
Arbëresha Ajdini-Nallbani, Predsedavajuća Skupštine Opštine

Predmet: Razmatranje zakonitosti Odluke

Poštovani,

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave je primilo Odluku br.02-245, usvojene od Skupštine Opštine Peć, sa ciljem ocenjivanja zakonitosti. Skupština Opštine Peć, dana 02.03.2011 donela je odluku, da cela nepokretnost bivših Poljoprivrednih Zadruga koje se nalaze na teritoriji opštine Peć, da se registruju kao društvena imovina na ime Skupštine Opštine Peć.

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave na osnovu svojih nadležnosti i zakonskog roka određenom u članu 81.4 Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br.03/L-040 član 5 i 6 Zakona Kosovske Agencije za Privatizaciju Br.03/L-067, Zakona o Davanju na Korišćenje i Razmenu Nepokretne Opštinske Imovine Br.03/L-226 posle detaljnog razmatranja ove odluke, konstatovalo je da je odluka *protivzakonita*.

- Na osnovu člana 6.1 Zakona Kosovske Agencija za Privatizaciju Br.03/L-067, Kosovska Agencija za Privatitaciju je nadležna za medadžiranje i administraciju sa društvenom imovinom na celoj teritoriji Republike Kosova, dok je odluka Skupštine Opštine Peć van mandata i nadležnosti Predsednika i Skupštine Opštine.


- Na osnovu člana 9 i člana 10 Zakona o Davanju na Korišćenje i Razmeni Nepokretne Imovine Opštine Br.03/L-226, opština odnosno opštinski organi za javne potrebe, mogu da podnesu zahtev KAP za uzimanje imovine koja je pod njenim menadžiranjem i administracijom, nadoknađivši na osnovu tržišne vrednosti ili preko razmene sa opštinskom imovinom.

Od onoga što je gore rečeno i sa ciljem potpunog sprovođenja Zakona za Lokalnu Samoupravu Br.03/L-040, Zakona o Kosovskoj Agenciji za Privatizaciju Br.03/L-067, kao i Zakonu o Davanju na Korišćenje i Razmeni Opštinske Nepokretne Imovine Br.03/L-226 Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave traži od opštinskih autoriteta, odnosno od Predsednika i Skupštine Opštine Peć, da na osnovu zakonskog roka odredjenog sa članom 82.2 Zakona o Lokalnoj Samoupravi, da odgovori zahtevu za *razmatranje* odluke sa kojom cela društvena imovina bivših "Poljoprivrednih Zadruga" koje se nalaze na teritoriji opštine Peć, da se registruju kao društvena imovina na ime Skupštine Opštine Peć, ili da preduzme mere za nadoknadu ove imovine u skladu sa zakonskim propisima, ili razmenu gore navadene imovine sa opštinskom imovinom.

MALS, je opredeljeno da nudi podršku i potrebnu pomoć za potpuno sprovođenje ovih obaveza koje proizilaze od sprovedljivog zakonodavstva za lokalnu samoupravu u Republici Kosovo.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović
Zamenik Premijera i Ministar MALS



Kopje: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-e
Dino Hasanaj, Predsednik Borda KAP
Škeljzen Luka, Direktor Menadžer KAP
Rozafa Ukimeri, Direktor SLS
Arhivi MALS-e



Në bazë të nenit 11 dhe nenin 14 paragrafi 1. të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04.qershor 2008) dhe nenit 11. paragrafi 1. të Statutit të Komunës së Pejës, 01.Numër: 09 – 8103 datë: 29.shtator 2008, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 28.dhjetor 2011, pas shqyrtimit të Propozimit për marjen e Vendimit mbi anulimin e Kontratës mbi bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të patundshmerisë ngast.kad.nr.687/4, Këshillit Komunal të LK.dhe KK.të SPS.-sit Pejë, si dhe bartjen e të drejtës së pronësisë në fjalë në trashigimtarin ligjor Komunën e Pejës, njëzërit muar këtë

V E N D I M

MIRATOHET propozimi i Drejtorisë për Çështje Pronësoro Juridike KK.Pejë, për anulimin - shfuqizimin e Kontratës Nr.03-466/134 dt.20.09.1991, mbi bartjen e të drejtës së pronës komunale në shfrytëzim ngast.kad.nr.687/4, në sipërfaqe prej 0.00,78 ha, në të cilën gjendet edhe lokali afarist, Këshillit Komunal të LK.dhe KK.të SPS.-sit, Pejë, mëqë ky subjekt nuk ekziston më dhe ta bejë bartjen e të drejtës së pronësisë në fjalë në trashigimtarin ligjor Komunën e Pejës.


Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Çështje Pronësoro Juridike e KK.Pejë.

Vendimi ti dërgohet: Drejtorisë për Çështje Pronësoro Juridike të KK.Pejë, MAPL.- Prishtinë, dhe një kopje i bashkangjitet Procesverbaliit nga takimi i Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me date: 28.dhjetor 2011.

L.Numër: 463 – 7446/2011
Pejë, date: 28.dhjetor 2011.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL PEJË

K R Y E S U E S J A,
Dr.Arbëresha Ajdini Nallbani



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO
 MINISTRIA E SHERBIMEVE PUBLIKE / MINISTARSTVO JAVNIH SLUZEBI / MINISTRY OF PUBLIC SERVICES
 AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

Të dhënat Bazë për Njësi
Osnovne Podatke Jedinice
Unit Base Data

Prova e Pajuaritshme / Nepokretnu Imovinu / Immovable Property: P-71611071-00687-4
 Data dhe Koha e Lëshimit / Datum i Vreme Izdavanja / Date and Time of Submission: 1/30/2012 - 10:31:42AM
 Komuna / Opština / Municipality: Pejë/Peć/Pejë
 Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: PEJË/PEĆ/PEJË
 Zyrti Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office

Zona / Zone / Zone	Referohet / Referenca / Reference	Bashkuar me / Spojena sa / Merged To	Referohet / Referenca / Reference	Sipërfaqja / Površina / Area
Subdivizi (pre) / Rastjelena od / Subdivided From				78
Shtimi / Note / Notes				78
77-1992				

Referencë / Reference / Reference	Sipërfaqja / Površina / Area
SHTETI - SDEKTESE / E.A. - ZGRADA / HOUSE - RESIDENTIAL BUILDING	78
	78

PRONARE/POSEDEUESI - VLASNIK/DRZALAC - OWNER/POSSESSOR

Të Dretat Prary Rights	Emri Inc Name	Nr. ID Lib. ID ID No.	Vendbanimi Residence	Rruga Ulica Street	Nr. Br. No.	Kati Sprat Floor	Pjesa e pronës Doo imovine Part of scale	Azhuaruar Azhurimato Updated
	P. SHI K. K. HEJE	KCID1618242	PEJE				1/1	Nga/Of/From KCID

Referenti / Referent / Referent


Drejtori / Direktor / Director